



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:261125

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05871445

KPPP.nr.2022/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përbarimore të kreditorit “Flota” SH.P.K., me numër unik identifikues 810044537 me adresë në Ferizaj fshati i vjetër, kundër debitorit NTP “Florenti” K.B. B.I., me adresë në Mitrovicë, Shemsi Ahmeti me numër unik identifikues 811305334, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.567/2023 të datës 09.11.2023 të Përbaruesit Privat Besnik H. Aliu, me seli në Ferizaj, jashtë seancës me datës 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit NTP “Florenti” K.B. B.I., i ushtruar ndaj Urdhrit P.nr.567/2023 të datës 09.11.2023 të Përbaruesit Privat Besnik H. Aliu,
- II. Urdhri Përbarimor P.nr.567/2023 i datës 09.11.2023 i lejuar nga Përbaruesi Privat Besnik H. Aliu, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Flota” SH.P.K., ka lëshuar Urdhrin Përbarimor P.nr.567/2023 të datës 09.11.2023 me të cilin e ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm, Faturës me nr. 63-210-1-V-23, Faturës me nr.70-210-1—V-23, Faturës me nr. 85-210-1-V-23, Faturës me nr.21-210-1V-23, Faturës me nr.2-210-1-V-23, Faturës me nr.10-210-1-V-23, Faturës me nr.3-210-1-V-23, Faturës me nr.43-210-1V-23, Faturës me nr.40-210-1-V-23, Faturës me nr,53-210-1V-23 dhe Faturës me nr.55-210-1V-23, me të cilin ka detyruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumën prej 1,130.63€ me kamatë ligjore prej 8% nga dita e rënies në vonesë deri në pagesën definitive si dhe të paguaj shpenzimet e procedurës përbarimore. Të gjitha këto detyrime duhet të realizohen përmes bllokimit të llogarive bankare

të debitorit të hapura në bankat komerciale dhe bartjen e tyre në llogarinë bankare apo përmes përmbarimit dhe sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen të bëhet inkasimi i borxhit.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, brenda afatit ligjor debitori ka ushtruar prapësim me të cilin ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarimor me arsyetimin se debitori dhe kreditori në cilësinë e operatorëve ekonomik kanë arritur marrëveshje ashtu që kreditori ta furnizoj debitorin me produkte të ndryshme në kompensim të kundërvlerës financiare për të cilën janë marr vesh në momentin e arritjes së marrëveshjes. Tutje ka shtuar se është e palogjikshme që dhe në kundërshtim me marrëveshjen e bashkëpunimit që të kërkohet kompensimi i mjeteve pa u bërë barazimi i obligimeve të operatorëve ekonomik. Andaj gjykatës i ka propozuar që të aprovoj prapësimin e debitorit në tërësi si të bazuar dhe të anulohet urdhri përmbarimor.

Kreditori brenda afatit ligjor përmes përfaqësuesit të autorizuar ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit si të pabazuara duke theksuar se asnjë nga thëniet e debitorit të paraqitura në prapësim nuk qëndrojnë. Ka shtuar se procedura përmbarimore është iniciuar në bazë të faturave të cilat janë dokument i besueshëm dhe të njëjtat janë paraqitur në përputhje me dispozitat ligjore. Andaj, me arsyetimin se nuk janë plotësuar shkaqet për prapësim, gjykatës i ka propozuar që të refuzoj në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Neni 29, paragrafi 1 i LPP-së, përcakton se: *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*

Gjykata vlerëson se Urdhri Përmbarimor P.nr.567/2023 i datës 09.11.2023 bazohet në dokumente të besueshme, përkatësisht Faturën me nr. 63-210-1-V-23, Faturën me nr.70-210-1—V-23, Faturën me nr. 85-210-1-V-23, Faturën me nr.21-210-1V-23, Faturën me nr.2-210-1-V-23, Faturën me nr.10-210-1-V-23, Faturën me nr.3-210-1-V-23, Faturën me nr.43-210-1V-23, Faturën me nr.40-210-1-V-23, Faturën me nr.53-210-1V-23 dhe Faturën me nr.55-210-1V-23, të gjitha në lartësi prej 1,130.63€, të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në to janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar mallrat me të cilat është shërbyer debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe të njëjtat janë bërë të arritshme për pagesë.

Po ashtu, gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat mbi bazën e të cilave është lejuar urdhri përmbarimor, i plotësojnë kushtet në kuptim të nenit 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat i janë bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal.

Ndërsa, lidhur me pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim në lidhje me barazimin e obligimeve gjykata vlerëson se ekzistimi apo jo i marrëveshjes midis palëve nuk është objekt shqyrtimi në këtë procedurë përmbarimore, Andaj, në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 2022/23, datë 28.06.2024

Gjyqtari
Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.